



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 12.12.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 13.08.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **NPN UNIVERS-MI** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas"** – Lot 2 (QKMF Drenas), me nr. prokurimi 206-24-6057-2-2-1, nxjerr:

#### V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE NPN UNIVERS-MI e datës 06.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas"** – Lot 2 (QKMF Drenas), me nr. prokurimi 206-24-6057-2-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 03.12.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 03.12.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

#### Arsyetim

Operatori Ekonomik NPN UNIVERS-MI ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas"** – Lot 2 (QKMF Drenas), me nr. prokurimi 206-24-6057-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 11.12.2024, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

\* NENI 1 Qëllimi

\* NENI 56 i LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

\* NENI 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

\* NENI 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës

\* NENI 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

**Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:**

Pas vlerësimit na dërgohet – B58 njoftim mbi vendimin e AK e datës 03.12.2024, ku shpërblehet me kontratë Operatori Ekonomik: N.N.SH Vizion Project me vlerë 27,528.87 Euro.

Po në të njëjtën datë Autoriteti Kontraktues na ka dërguar letër standarte për tenderuesin e eleminuar.

Me datën 04.12.2024 ne si Kompani kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare, ku qasja na është mundësuar me datë 05.12.2024 nga ora 10:00, ku edhe kemi shkuar për qasje. Gjatë kontrollimit të dokumentacionit kemi hasur në shkelje të LPP-së nga ana e AK-së.

**PRETENDIMI NR.1**

**AK ka shkelur Nenin 1**

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

**SQARIM :**

AK nuk e ka respektuar Nenin 1 (pika 1) duke e shpërblyer OE me çmim me të lartë dhe duke e dëmtuar buxhetin e shtetit në vlerë prej 11,011.55 Euro.

**PRETENDIMI NR.2**

AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së –

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

AK na ka eleminuar me arsyetimin:



ARSYETIMI

Oferta juaj është e papërgjegjshme, mospajtimtare dhe e keqsi plotëson kriterin ashtu siç është kërkuar në DT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Ne njoftimin për kontratë dhe në Dosje të Tenderit të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kërkesa 7 ka qene:

<p>Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses kontrata të ngjashme në mbikëqyrje të projekteve, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 50,000 Euro për secilin Lot që oferton, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë. Të ketë mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë. Në rast të konsorciumit, lideri duhet ta plotësoj min. 60% të kërkesës.</p>	<p>Dëshmia 2. Një listë të kontratave të realizuara, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, të dhënat e personit kontaktues dhe përfituesin. Listës ti bashkëngjiten Referencat ose Certifikatat e pranimit.</p>
--	---

Operatori ekonomik N.P.N. "UNIVERS-MI" në listën e projekteve të realizuara për të mbuluar kriterin e lartë cekuar "se ka mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë" ka ofruar një reference se bashku me ofertën, ku si pjesë e konsorciumit me OE P.M.N. SH.P.K e ka mbikëqyr "Ndërtimi i ambulances në fshatin Veriq" në bazë të kontratës së lidhur me Komunën e Junikut për mbikëqyrje: "Mbikëqyrja e projekteve për infrastrukturë", me numër prokurimi 633-22-6174-2-2-1.

Kjo reference si e tillë nuk mund të merret si e pranueshme pasi që në kontratën për mbikëqyrje me numër prokurimi 633-22-6174-2-2-1, afati i fundit për kryerjen e të gjitha shërbimeve është 27.07.2025, ndërsa hapja e ofertave për këtë aktivitetin ka qene me date 08.07.2024. Bazuar në këtë fakt Operatori ekonomik N.P.N. "UNIVERS-MI" nuk e plotëson Kriterin ( Kërkesën 2) të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në njoftimin për kontratë dhe Dosje të Tenderit sepse kjo kontratë nuk ka qene e përfunduar në kohën e hapjes së ofertave.

Kërkesa e AK-së

<p>Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses kontrata të ngjajshme në mbikëqyrje të projekteve, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 55,000,000 Euro per secilin Lot që oferton, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë. Të ketë mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë. Në rast të konsorciumit, lideri duhet ta plotësoj min. 60% të kërkesës.</p>	<p>Dëshmia 2. Një listë të kontratave të realizuara, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, të dhënat e personit kontaktues dhe përfituesin. Listës ti bashkëngjiten Referencat ose Certifikatat e pranimit.</p>
---	---

**SQARIM :** Kërkesa nga AK ka qenë e qartë që OE duhet të dorëzoj një projekt të mbikqyrur nga sektori i shëndetësisë brenda tri viteve të fundit nga njoftimi për kontratë. Ne kemi dorëzuar një projekt të kryer nga OE Punëkryes të përfunduar me date 02.02.2023 që e plotëson kërkesën e AK të kërkuar në njoftimin për kontratë dhe DT. Nëse PRETENDIMI nr.2 sipas jush nuk e plotëson kërkesën e AK , në PRETENDIMIN nr.3 ju paraqesim edhe kontratën dhe referencën e projektit qeter nga sektori i shëndetësisë, që i përket kontratës tonë për mbikqyrje në koncorzium me kompaninë P.M.N. SH.P.K., të listuar me nr rendor 2 në listën e projekteve të ngjashme të ngarkuar në E Prokurim.



Data: 05.07.2024

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Titulli i projektit: 'Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas'

Nr. prokurimi: 206-24-6057-2-2-1

Projekti me titull: "Ndërtimi i ambulances në fshatin Veriq"

Numri i prokurimit: 633-22-5241-5-2-1

Projekt ka qene në mbikëqyrje përmes kontratës me AK: Komuna e Istogut

Nga koncorziumi: P.M.N. SH.P.K.& N.P.N UNIVERS MI - Mbikëqyrja e projekteve për infrastrukturë - 633-22-6174-2-2-1




REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË

Numri i kontratës: 633-22-5241-5-2-1/C573

KOMUNA E ISTOGUT, Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

" AAG PROJEKT " SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 82/7, PRISHTINË, me NRB 810200840, të cilën e përfaqëson z. Bajram Beqiraj (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

**NDERTIMI I AMBULANCES NE FSHATIN VERIQ** me numër identifikues: 633-22-5241-5-2-1

### Neni 1 Lënda

~~L.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: NDERTIMI I AMBULANCES NE FSHATIN VERIQ~~

Nr. i prokurimit	633-22-5241-5-2-1/C573
I brendshëm	633 022 020 521 / C573

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 49 645,15 €; *(fjole)*  
Katërdhjetëenëntë mijë e gjashtëqindkatërdhjetë Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë o vetnija pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(Plani për menaxhimin e kontratës)

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën, dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë me sipër.

**Neni 4**

4.1 Të gjitha punimet rreth aktivitetit të prokurimit në fjalë do të fillojnë pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundohen për menaxhim të kontratës dhe do të përfundojnë brenda 3 muaj apo 90 ditë kalendarike

**Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftim", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	12.08.2022
Vula:	

**Për Kontraktuesin**

Emri:	Agron Beqiraj
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	12.08.2022
Vula:	





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opštine Istok  
Municipal Istog

Drejtorija për Shëndetësi / Direkcija za Zdravstvo / Department of Health

LISTË E DISTRIBUIMIT/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

REFERENCË:	06. Nr.5		
PËR/ZA/TO:	"AAG-PROJEKT" SH.P.K.		
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Dr. Zenel Shatri , drejtor		
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Referencë		
Nr.i zyrës	206	Lokacioni:	Datar
Br. kancelarije		Kucni:	Datum:
Room No.:		Extension:	Date:
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input checked="" type="checkbox"/>

Duke u bazuar në kërkesën nr.06/016/4869 të parqitur nga OE "AAG-PROJEKT" SH.P.K. nga Prishtina, Drejtorati për Shëndetësi lëshon këtë :

REFERENCË

Me të cilën konstatohet se Operatori Ekonomik "AAG-PROJEKT" SH.P.K. nga Prishtina, bazuar në Kontratën nr. 633/-22-5241-5-2-1, me titull "Ndërtimi i Ambulancës në fshatin Veriq", raportin e organit mbikqyrëse "PMN" sh.p.k, Operatori Ekonomik i ka realizuar punimet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në kontratë. Vlera e punëve të kryera për këtë aktivitet ka qenë 49,645.15€.

Shuma e mjeteve të paguara për këtë aktivitet për vitin 2022 ka qenë 45,000.00€ ndërsa shuma prej 4,645.15€, mbetet si obligim për vitin 2023.

PRETENDIMI NR.3

AK ka shkelur nenin 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të kësaj ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

## SQARIM

Ne E-Prokurim kemi te ngarkuar listen e kontrateve te realizuara brenda tri viteve te fundit, ku gjithesej jane te paraqitura 3 kontrata.



Lista e kontratave - N.P.N. "UNIVERS-MI", Prishtinë					
1	* Mbikqyrja e Projektit të objektit ndërtimor "XHAFI CONSTRUCTION B+P+SK"; Fushëkosovë, punët e vrazhda ndërtimore dhe punët finale- përfshirë të gjitha fazat	* XHAFI CONSTRUCTION * SH.P.K [ NR.BIZ. 810109430	2018-2021	Enver Kulllovi ( Investitor )	30,000.00
2	* Mbikqyrja e projekteve kapitale me nr.prokurimi: 633-19-436-2-2-1	KOMUNA E ISTOGUT	2019-2022	Gezim Ademaj ( Menaxher i Prokurimit ) gezim.ademaj@rks-gov.net	41,400.00
3	* Mbikqyrja profesionale për realizimin e projekteve ndërtimore dhe Infrastrukturës për nevojat e AME-së me nr.prokurimi: 214-21-02-236	AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT	2021-2022	Lulzim Bajrami ( Udhëheqës i Divizionit të Prokurimi) lulzim.bajrami@rks-gov.net	1,250.00
TOTAL:					72,650.00



N.P.N. "UNIVERS-MI"  
Prishtinë

05.07.2024

Kontrata nr.2 përmban një projekt nga sektori i shëndetësisë,

Titulli: "Lot 1-Ndërtimi i ambulances ne Uçë"

Numri i prokurimit: 633/021/4504/5-2-1/C481,

ku AK ka shkelur nenin 72 duke mos kërkuar informata shtesë, sepse për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Të bashkangjitur gjeni dëshminë e kontratës dhe references tonë për mbikqyrje të komplet projekteve si dhe kontratën dhe referencen e OE Punekryes për këtë projekt:





Republika e Kosovës



Komuna Istog

Me kërkesë të Kompanisë " Me kërkesë të Kompanisë-Konzorciumit "PMN"shpk & NPN"UNIVERS-MI", me seli në Prishtinë me drejtor z.Zenun Tolaj

#### REFERENCË

Me të cilën konstatohet se kompania "PMN"shpk & NPN"UNIVERS-MI", me seli në Prishtinë me drejtor z.Zenun Tolaj, në emër të Konzorciumit, e regjistruar me numër të biznesit 70631342 & 70907674, i ka mbikqyrë Projektet Aktivitetet me titull: "MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE NË KOMUNËN E ISTOGUT me nr. prok: nr.prok.633-019-436-221/FA/36 & 633-019-002-221

Vlera e parashikuar e kontratës kornizë: 41.400,00 PËR VITIN BUGJETOR -2019-2022.

Kontraktuesi respektivisht Kompanija mbikqyerse me përpikëri ju ka mbikqyrë projekte bazuar në kërkesat e Menaxherit të projektit aktivitetit dhe është përmbajtur kushteve të kontratës si nga aspekti kohor ashtu edhe nga aspekti i profesional.

Projekt Menaxheri i kontratës z. Zenun Tolaj & Bardhë Jetishi, tregoi angazhim të madh duke siguruar që projektet e kontraktuara të përfundojnë me kohë. z. Zenun Tolaj & Bardhë Jetishi ka qenë profesional i përgjegjshëm çka e vlerësoj për aftësitë e tij në menaxhim dhe profesionalizëm.

Referenca i lëshohet me kërkesën të konzorciumit dhe shërben për kompletimin e dokumentacionit të kompanisë dhe të Menaxherit për nevojat e saj-tij për të shprehë konkurrencë pran Autoriteteve Kontraktuese.

26.08.2021



Zyra e Prokurimit

Gëzim Ademaj



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

**KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR SHERBIME**  
(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

KONZORCIUMI "PMN" SHPK & NPN "UNIVERS-MI" nga Prishtina, Komuna e Prishtinës, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 70631342, përkatësisht 70907674 të cilin e përfaqëson, z. Zenun Tolaj, ne cilësnë e "kryersi i shërbimeve", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

**MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE**

Nr. I prokurimit	633-19 – 436 -2-2-1/ FA/036
Nr. I brendshëm	633 / 019/ 002-2-2-1

**Neni 1 Lënda**

1.1.Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për shërbimet si në vijim: **Mbikqyrja e projekteve kapitale**, si dhe kryerja e shërbimeve ndihmëse nga ofruesi I shërbimeve siq është përcaktuar në dosjën e tenderit.

**MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE**

Specifikimi i detyrueshem teknik dhe fomulari i çmimeve i datës 07. 03. 2019 është pjesë përberese e kontratës dhe e njëjti është bazë për pagesen e kontraktorit.

Autoriteti Kontraktues bënë kryerjen e shërbimeve vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek kryesi I shërbimeve, duke specifikuar listën me projektet perkatëse.

1.3 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË 23.05.2019 DHE DO TË PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME 22.05.2022 PASI KONTRAKTORI TE SJELLË DESHMINË MBI SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMËRI PREJ 37 MUAJVE, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

## Neni 2 Koha e perfundimit

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha SHËRBIMEVE do të jetë: ~~22.05.2022~~ si afat I skadimit te afatit te kontratës.

2.2 Vendi i kryerjës së shërbimeve do të jenë **KOMUNA E ISTOGUT** –

2.3. Obligimet e kontraktorit (kryesit te shërbimit) janë të gjitha shërbimet të percaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.4 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.5 Kontrata mund te shkëputet edhe para këtijë mund te shkëputet edhe para ketijëafati, po qe se kontrata permbushe me çmim sipas dispozitave te Nenit 56.10 te Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

## Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i kësajë kontrate është: 41.400,00

Vlera totale 36 Muajshe kontratës është: **41,400,00 Euro.**

**Dhe me shkronja: /Dyzetenjëmijëekatërçindeuro/**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.



3.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

## **Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

### *Planit për menaxhimin e kontratës*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë

miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe] 2 në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:

"PMN" & NPN "UNIVERS-MI"

Emri:	Ziçë Bujupaj	Emri:	Zenun Tolaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	M e n a x h e r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.5/2019	Data:	23.05.2019
Vula:		Vula:	

## KONTRATE

Dhënie e kontratës: 633-21-4504-5-2-1

KOMUNALITETI QYTAR I SHËNËZËRIT (në vazhdim "Komuniteti Shënëzëzërë"), në qytetin e Shënëzërës,

"AAQI PROJEKTI" SH.P.K., Agjenci Ramadani Nr.81/3, PRINDEBËR, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në bashkëpunim me Komitetin e Bërthamës së Kontraktimit të Përbashkët të Qytetit të Shënëzërës,

LOTI - SHËRIME TË AMBULANCËS NE PSYCHIATRIKË, me adresë identifikuese: 633-21-4504-5-2-1

Neni 1. Lenda

1.1 Lenda e kontratës qëdo shkëputet i përbëhet në vijim nga ato e Kontraktimit LOTI - SHËRIME TË AMBULANCËS NE PSYCHIATRIKË, me adresë identifikuese: 633-21-4504-5-2-1

Nr i Prokurimit	6330214504/5-2-1/C 431
I brendshëm	633021037521 LOT

Neni 2. Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 39.849,33 €, Tërbëhet nga shërbimet që ofrohen në adresën: 633/100 [shërbime të punëve në fildë] Bura.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 në sipër duhet të jetë e vetëja paguere që Artoreshi Kontraktues i ka bërë Kontraktimit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënvizohet ndryshimisht.

2.3 Pajisja do të bëhet në papir me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3. Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kërkuarorit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Parametri dhe Paralogjia);

(Për sec. nënvizimin e kontratës)

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën, dhe në rastet të papërcaktimit ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë në sipër.

<sup>1</sup> Në Anëtarësimin e Komitetit të Kontraktimit të Përbashkët të Qytetit të Shënëzërës, pjesë e të cilës kontraktuesit që bëjnë anëtarësim.



**Art. 1. Objekt i përmbajtjes së kontratës**

1.1. Të gjitha punimet përfshirë në krah të kësaj kontrate do të përfshihen brenda skemës së mëposhtme të punës nga data e afërkuptimit të kontratës dhe të njëjtit do të rishpëzohet me datën 04.09.2021 dhe do të përfshihen në datën 07.11.2021.

**Art. 2. Komunikimet**

2.1. Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të bëhen direkt në kontratën dhe mund të jenë identifikues dhe duhet të dërgohen me postë, fax, email ose të dorëzohen personëlisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

2.2. Nëse personi që dërgon komunikimin kërkon vërtetimin të pranimos së saj, ai duhet të thotë këtë në komunikimin e tij. Nëse kjo bëhet në afat të fundit për pranimos e komunikimit me shkrim, dërguesi duhet të kërtojë vërtetimin të pranimos të komunikimit së tij. Në të gjitha raste, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimos e komunikimit të tij.

2.3. Kudo në kontratë parashikohet për dënimin e ndonjë qëndrimit, përfundim, miratim, certifikatë, ose vendim, përveç nëse specifikohet ndryshe në afatim të tillë, përfundim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkronjave "njohim", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendos" dhe të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të atakohet apo vendoset pa arsye.

2.4. Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën në tërë origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Gëzim Ademi
Posta:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	09.09.2021
Vula:	

**Për Kontraktuesin**

Emri:	Agron Beqira
Posta:	M e a s h e r
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	09.09.2021
Vula:	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Data: 17.12.2020  
Lënda: Raporti i Verifikimit  
Titulli i Kontratës: "Ndërtimi i Ambulancës në Uçë--Lot 1"  
Nr.Prokurimit: 633/021-/037/521 LOT1

#### Raport i verifikimit të punimeve

Ky raport përmban informata mbi procesin e realizimit të punimeve të kryera të projektit: "Ndërtimi i Ambulancës në Uçë LOT 1", lidhur me punimet e realizuara në projektin me Nr. të prokurimit: 633/021/037/521 LOT1, në vlerë të kontratës prej: 39,846.35 € nga ana e operatorit ekonomik "AAG PROJEKT SHPK- PRISHTINË.

Bazuar në raportin e mbikëqyrësit "P.M.N" SHPK-PRISHTINË, për punët ndërtimore të përfunduara të 13.12.2021, komuna e Istogut, respektivisht Kryetari i komunës ka cakluar me vendim nr.01-795/2021, 15.12.2020, komisionin e përbërë prej 3 anëtarëve, për verifikimin e sasive për projektin në fjalë.

1. Jakup Blakaj, Inxh. I ndërtimtarisë, Kryetar komisioni;
2. Fisnik Shashoj, Zyrtar Uqjor në drejtorinë e shëndetësisë, anëtarë;
3. Kamer Berisha, Mirëmbajtës në QKMF, anëtarë.

Komisioni në përbërje të plotë dhe në prezencën organit mbikëqyrës, doli në vend të ngjarjes me datë : 16.12.2021, duke filluar në orën 10:00 dhe duke vazhduar deri në orën 13:00, njëzëri konstatuan së:

1. Investitor i punimeve është Komuna Istog.
2. Kryesi i punimeve është "AAG PROJEKT" SHPK.
3. Punët e kryera janë të lamisë së ndërtimit.
4. Kompania "AAG PROJEKT" SHPK është shpërblyer nga Komuna e Istogut për tenderin "Ndërtimi i Ambulancës në Uçë LOT 1", për kryerjen e punëve është lidhur kontratë me nr. 633/021/037/521 LOT1.

5. Dokumentacioni tekniko-investues (paramasa dhe parallogaria), i punuar nga Komuna.
6. Organi mbikëqyrës: P.M.N SHPK-Përfaqësues Zenun Tolaj.

Komisioni pas verifikimit të dokumentacionit të ofruar nga organi mbikëqyrës për projektin e lartcekur (situationet, matjet gjeodezike të punimeve, testet e cilësisë së punimeve nga laboratorit i certifikuar, projektin e punëve të ekzekuluara) dhe ekzekutimin e punimeve në punishte si dhe bazuar në raportin e mbikëqyrësit, bie këtë:

#### KONSTATIM

1. Që punët e kryera për projektin "Ndërtimi i Ambulancës në Uçë LOT 1", janë të kryera sipas kontratës dhe llogarisë - prerjes së punëve, situacionit përfundimtar nga organi mbikëqyrës.
2. Andaj lejohet të bëhet pagesa për punën e bërë në bazë të llogarisë përfundimtare të ofruar nga organi mbikëqyrës.

Përfaqësi/ Kompania "AAG PROJEKT" SH.P.K

Komisioni i Verifikimit :

1. Jakup Blakaj,

2. Fisnik Shoshaj,

3. Kamer Berisha,

Punimet janë përcjell gjatë gjithë kohës nga menaxheri i kontratës.

Vërejtje nuk ka, cilësia e punimeve është shumë e mirë.

Rekomandojmë që operatorit ekonomik li bëhet pagesa e shumës së mbetur prej: **3,952.00 €** nga autoriteti kërkuar, me qëllim që të realizohet vlera totale e kontratës prej: **39,849.35 €**, nga operatori ekonomik "AAG PROJEKT" SH.P.K

Duke u bazuar në punët e kryera në teren dhe në bazë të përshkrimeve të paramasës dhe parallogarisë, rekomandojmë që të finalizohet kontrata në tërësi pasi që vërejtje nga ana e komisionit nuk ka.





AK:	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
Datë:	05.07.2024
Tema:	Mbikqyrja e objekteve shëndetësore

Projekti me titull: "Lot 1-Ndërtimi i ambulances ne Uçe"

Numri i prokurimit: 633/021/4504/5-2-1/C481

Projekti ka qene në mbikqyrje përmes kontratës me AK: Komuna e Istogut

Mbikëqyrja e projekteve kapitale : 633-019-436-221

Projekti me titull: "Ndërtimi i QMF-së në Apterushë"

Numri i prokurimit: 623-20-1388-5-2-1

Projekti ka qene në mbikqyrje përmes kontratës me AK: Komuna e Rahovecit

Mbikëqyrja e investimeve kapitale : 623-20-6834-2-2-1



## Kërkesa e AK-së për projekte të ngjashme

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses kontrata të ngjashme në mbikëqyrje të projekteve, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 55,000,000 Euro për secilin Lot që oferton, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë. Të ketë mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë. Në rast të konsorciumit, lideri duhet ta plotësojë min. 60% të kërkesës.

Dëshmia 2. Një listë të kontratave të realizuara, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, të dhënat e personit kontaktues dhe përfituesin. Listës të bashkëngjiten Referencat ose Certifikatat e pranimit.

SQARIM: OE i shpallur fitues ka dorëzuar një listë prej 9 kontratave të përfunduara, ku vetëm kontrata nr.1 dhe nr.2 kanë si aktivitet edhe mbikëqyrjen e punimeve, por kanë edhe aktivitete tjera të projektimit, dhe studimin e fizibilitetit që do të thotë se:

Kontrata nr 1 ka vlerën 162,000.00 pa TVSH

Kontrata nr 2 ka vlerën 27,000.00.

Keto vlera të këtyre dy kontratave janë të përgjithësuara, dhe nuk janë të ndara sa është vlera e projektimit, sa e mbikëqyrjes, sa e studimit të fizibilitetit.

AK ka shkelur nenin 59 pika 2 sepse është dashur të kërkojë sqarim nga OE i shpallur fitues paramasat ofertuese në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin e ofertave sipas kërkesës së kërkuar në njoftimin për kontratë dhe DT që ka qenë të ofrojë mbikëqyrje në vlerë prej 55,000.00 Euro në periudhën e shkuar 3 vjeçare.

### Dëmet materiale

- Kompania UNIVERS-MI së pari do ta humbasë të drejtën e kontratës, që me të drejtë do të na takonte, bazuar në Nenin 6 Të Ligjit të Prokurimit Publik.
- Koha dhe shpenzimi të hollave për përgatitjen e tenderit (gjetjen e stafit adekuat për realizimin e kontratës),
- Ka shkaktuar ngecje në proceset tjera të kompanisë,
- si ngecje në pjesëmarrjen e tenderëve tjerë
- demtim të reputacionit,
- si dhe humbjen e resurseve humane etj.

**Pergjigjja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:**

Kerkesa juaj per rishqyrtim eshte trajtuar me mjaft vemendje nga ZPP dhe komisioni vleresues dhe pas shqyrtimit te pretendimeve dhe deshmive te prezantuara, konstatojme se eshte i pa bazuar pretendimi juaj ankimorë, kur e kontestoni arsyen e eliminimit per mos plotesimin e kriterit te Të ketë mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë bazuar ne deshmite e me poshtme.

Gjate Ri-vleresimit te aktivitetit eshte shqyrtuar dokumentacioni i ofertes tuaj, pjese e te ciles eshte edhe Lista e projekteve te realizuara nga ana juaj, e cila permbane 3 projekte si ne tabelen:

Lista e kontratave - N.P.N. "UNIVERS-MI", Prishtinë					
1	"Mbikqyrja e Projektit të objektit ndërtimor "XHAFI CONSTRUCTION B+P+SK", Fushëkosovë, punët e vrazhda ndërtimore dhe punët finale- përfshirë të gjitha fazat"	"XHAFI CONSTRUCTION" SH.P.K ( NR.BIZ. 810109430)	2018-2021	Enver Kullolli ( Investitor )	30,000.00
2	"Mbikqyrja e projekteve kapitale" me nr.prokurimit: 633-19-436-2-2-1	KOMUNA E ISTOGUT	2019-2022	Gezim Ademaj ( Menaxher i Prokurimit ) gezim.ademaj@riks.gov.net	41,400.00
3	"Mbikqyrja profesionale për realizimin e projekteve ndërtimore dhe Infrastruktura për nevojat e AME-së" me nr.prokurimit: 214-21-02-236	AGJENDIA E MENAXHIMIT EMERGJENT	2021-2022	Lulzim Bajrami ( Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit ) lulzim.bajrami@riks.gov.net	1,250.00
TOTAL:					72,650.00

Sa i perket projektit te prezantuar "Ndertimi i ambulances ne fshatin Veriq" me nr. te prokurimit Numri i prokurimit: 633-22-5241-5-2-1, ky projekt eshte mbikëqyrur nga ana juaj ne kuader te kontrates kornizë "Mbikqyrja e projekteve per infrastrukture" qe keni me komunën e Istogut me nr. 633-22-6174-2-2-1, ne te cilen kontrate lider i grupit eshte kompania PMN dhe ju jeni si anetare i grupit. Kjo kontrate kornize 3 vjeqare ende eshte ne implementim dhe nuk eshte perfunduar, nuk figuron ne Listën e kontratave, ne tabelen me larte, andaj ambulanca ne Veriq si pjese e kesaj kontrate tri vjeqare nuk merret parasysh deri pas perfundimit te kontrates kornize me komunën e Istogut.

Sa i perket mbikëqyrjes se Ambulances ne Uçë, sipas deshmive te prezantuara nga ana juaj, kontrata e puneve per kete projekt me nr. kontrate 633-021-4504-5-2-1/C481 eshte e nenshkruar me dt. 09.09.2021, ndersa referencen qe ju e keni prezantuar per realizimin e kontrates "Mbikqyrja e projekteve kapitale ne komunën e Istogut" me nr. 633-019-436-221/FA/36 eshte e dates 26.08.2021. Sipas kesaj deshmohet se data e references eshte para dates se kontrates se puneve andaj edhe nuk mund te merret si reference qe e mbulon edhe mbikëqyrjen e Ambulances ne Uçë.


Ndersa sipas Raportit te Verifikimit i dates 17.12.2020 (si duket viti 2020 ne daten e raportit mund te jete gabim teknik) ne kete raport potencohet si mbikqyres vetem kompania "P.M.N." Shpk me perfaqesues Zenun Tolaj.

Vullneti i AK ka qene per shperblimin e juaj siç u kemi shpallur fitues heren e pare, meqense keni ofertuar me çmimin me te lire dhe e kemi arsyetuar sipas sqarimit tuaj edhe çeshtjen e Çmimit jo normalisht te ulet, por pas pretendimeve ankimore te ankeses ne OSHP, vendimit te OSHP-se nr. 0772 qe e ka kthyer lenden ne rivleresim, eshte bere rivleresimi dhe sipas sqarimeve me larte jane evidentuar defektet e lartcekura.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit